

16 PRILL 2020

Masat e marra në kuadër të Pandemisë COVID-19 nga Autoritetet Shqiptare

Për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 Autoritetet Shqiptare kanë marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e tij. Më poshtë janë të listuar të gjitha masat e ndërmarra deri më datë 16 Prill 2020.

## Përmbajtja

Akt normativ Nr.14, date 11.04.2020- Për disa ndryshime dhe shtesa për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.....	2
Vendim KEC Nr.7, date 09.04.2020 – Për disa ndryshime mbi masat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19.....	2
VKM Nr. 284, date 10.04.2020 “Për disa ndryshime mbi masat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe pagesës të pa të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19.”.....	3
VKM Nr.277, date 06.04.2020-Për garancinë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga VKM në kuadër të menaxhimit të të situatës. ....	3
Urdhër Nr. 256, date 10.04.2020 “Për disa ndryshime në mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë.” .....	4

Akt normativ Nr.14, date 11.04.2020- Për disa ndryshime dhe shtesa për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Akt normativ Nr.14, date 11.04.2020- Për disa ndryshime dhe shtesa për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.](#)

Të gjithë qiramarrësit, persona fizikë/juridikë, me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, pavarësisht nëse e kanë të lejuar apo të ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Autoritetet kontraktore, me qëllim përmbushjen e nevojave për mallra/shërbime të nevojshme, për një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për raste veçanërisht të leverdishme, që paraqiten në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim më të ulët se çmimet normale të tregut, për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e shkaktuar nga COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, për përballimin e nevojave emergjente, kryejnë procedura prokurimi me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit dhe lidhin kontratat e furnizimit për këto mallra me operatorët ekonomikë të referuar si “biznesi i përpunimit aktiv”, sipas parashikimeve të Kodit Doganor

Vendim KEC Nr.7, date 09.04.2020 – Për disa ndryshime mbi masat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Vendim KEC Nr.7, date 09.04.2020 – Për disa ndryshime mbi masat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë leke, ndihmës ekonomike dhe pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19.](#)

VKM Nr. 284, date 10.04.2020 “Për disa ndryshime mbi masat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe pagesës të pa të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19.”

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[VKM Nr. 284, date 10.04.2020 “Për disa ndryshime mbi masat për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë leke, ndihmës ekonomike dhe pagesës të pa të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19](#)

Aplikimi për të përfituar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të vete punësuarit/të punësuarit. Individët, të cilët janë në më tepër se në një liste pagesë, kur të dy aktivitetet janë të mbyllur si pasojë e masave shtrënguese, përfitojnë si ndihmë financiare vetëm një pagë minimale. Në rastin kur vetëm një prej aktiviteteve rezulton i lejuar, individi, i cili është në më tepër se në një listë pagese, nuk e përfiton ndihmën financiare të pagës minimale.

Përfituesit e ndihmës financiare janë individët e vetëpunësuar/punësuar në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, sipas kategorizimit të mëposhtëm:

1. Personat fizikë të vetëpunësuar;
2. Punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;
3. Të punësuarit në personat fizikë tregtarë;
4. Të punësuarit në personat juridikë.”

VKM Nr.277, date 06.04.2020-Për garancinë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga VKM në kuadër të menaxhimit të të situatës.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[VKM Nr.277, date 06.04.2020-Për garancinë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga VKM në kuadër të menaxhimit të të situatës.](#)

Këshilli i Ministrave vendosi:

1. Miratimin e linjës së garancisë shtetërore, në vlerën 11 000 000 000 (njëmbëdhjetë miliard) lekë, në favor të bankave të nivelit të dytë, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.
2. Linja e garancisë shtetërore lëshohet në favor të secilës bankë të nivelit të dytë, si më poshtë vijon:
  - “Raiffeisen Bank”, sh.a., Albania, në vlerën 1 900 000 000 lekë;
  - “Banka Tirana”, sh.a., në vlerën 600 000 000 lekë;
  - “Banka Union”, sh.a., në vlerën 600 000 000 lekë;
  - “Banka Intesa Sanpaolo Albania”, sh.a., në vlerën 900 000 000 lekë;
  - “Banka Kombëtare Tregtare”, sh.a., në vlerën 1 900 000 000 lekë;
  - “Banka OTP Albania”, sh.a., në vlerën 1 100 000 000 lekë;
  - “Banka Procredit”, sh.a., në vlerën 400 000 000 lekë;
  - “Banka Alpha Albania”, sh.a., në vlerën 700 000 000 lekë;
  - “Banka Amerikane e Investimeve”, sh.a., në vlerën 500 000 000 lekë;
  - “Banka Credins”, sh.a., në vlerën 2 000 000 000 lekë;
  - “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, sh.a., në vlerën 100 000 000 lekë;
  - “Banka e Parë e Investimeve, Albania”, sh.a., në vlerën 300 000 000 lekë.
3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse, nëse është e nevojshme, sipas raportit të strukturës së posaçme ndërinstitucionale, i propozon Këshillit të Ministrave rialokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezuaruar shumën e garancisë në favor të tij te huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.

[Urdhër Nr. 256, date 10.04.2020 “Për disa ndryshime në mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë.”](#)

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Urdhër Nr. 256, date 10.04.2020 “Për disa ndryshime në mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë.”](#)

Në Urdhrin Nr. 193, date 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve ne Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

Lejohen te kryejnë aktivitetin e tyre vetëm ne fashën orare 05:00 – 17:30, duke filluar nga dita e Hënë date 13.04.2020, pikat e shitjes se produkteve ushqimore, me pakice dhe shumice, pikat e tregtisë se barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.

Hyrja ne aktivitetet e përcaktuara mesiper lejohet vetëm për një person, te autorizuar, për çdo familje për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do te jete vetëm një here ne dite dhe do te ketë një afat prej 90 minutash gjate fashës orare 05:00 – 17:30.